



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1892/ Prot.
2

Tiranë, më 18.07.2024

VENDIM

Nr. 50 dt. 18.07.2024

**“PËR
MIRATIMIN E KONTROLLIT TË TESTIT FIZIK SPECIFIK PËR PËRBALLIMIN
FIZIKISHT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT, PËR STUDENTËT FITUES NË
KONKURSET E PRANIMIT, PËR VITIN 2024-2025, NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS SI DHE KOHËN E KRYERJES SË PAGESËS SË TARIFËS
SË KËTIJ TESTI”**

Mbështetur në nenin 3, nenin 37, nenin 38 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 7, nenin 19, nenin 20 të Statutit të UST-së, nenin 7 të Rregullores së UST, në vendimin nr.57 datë 26.05.2023 të Senatit Akademik “Për miratimin e çmimeve referencë të listës së analizave dhe testeve që do të kryhen në laboratorët e Universitetit të Sporteve të Tiranës nga studentët e ciklit të dytë dhe të tretë”, në vendimin nr.41 datë 29.05.2023 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e çmimeve referencë të listës së analizave dhe testeve që do të kryhen në laboratorët e Universitetit të Sporteve të Tiranës nga studentët e ciklit të dytë dhe të tretë”, pas propozimit nga Rektorati, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.07.2024,

V E N D O S I :

1. Studentët fitues në konkurset e pranimit të programeve të Ciklit të I-rë bachelor në FSHL dhe FVFR, për vitin akademik 2024-2025, t’i nënshtrohen kontrollit të testit fizik-specifik për përballimin fizikisht të programit të studimit.
2. Tarifa e kontrollit të testit fizik specifik do të kryhet në të njëjtën kohë me pagesën e tarifës së regjistrimit të fituesve të konkursit të pranimit.
3. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, Administratori i UST, FSHL, FVFR, IKSSH, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

